



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë më 17 tetor 2019  
Nr. Ref.:RK 1447/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI141/18**

Parashtrues

**Budimir Ristić**

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC -1-12-0112-A0001 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 26 prillit 2018**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Budimir Ristić, nga Çagllavica (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Visar Vehapi, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin AC-1-12-0112-A0001 e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) të 26 prillit 2018.
3. Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit AC-1-12-0112-A0001, i 26 prillit 2018, iu dorëzua përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës më 17 maj 2018.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit] paragrafët 1 dhe 2 të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt); nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përveç kësaj, parashtruesi konsideron se gjatë procedurave në gjykatat e rregullta është shkelur edhe Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 17 shtator 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 9 tetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërçhaliju-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
9. Më 12 tetor 2018, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ta plotësojë formularin zyrtar të kërkesës.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.



11. Më 2 nëntor 2018, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.
12. Më 10 shtator 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Më 18 dhjetor 1964, paraardhësi ligjor i parashtruesit të kërkesës, tani i ndjeri D. R., ka nënshkruar kontratën Ov. nr. 2841/64, për shitblerjen e pronës së patundshme me KBI "Kosova Eksport" nga Fushë-Kosova (në tekstin e mëtejme: KBI).
14. Sipas kësaj kontrate D. R. për një sasi të caktuar të të hollave ia ka shitur KBI-së, ngastrat kadastrale të tokës me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.62.18 ha, të cilat gjendeshin në zonën kadastrale të Çagllavicës.
15. Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: PPK) në vitin 1995 parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër "MDD Ratar" që ishte pasardhësi ligjor i KBI-së, që ta anulojë kontratën e shitblerjes Ov. nr. 2841/64, të 18 dhjetorit 1964.
16. Më 8 maj 1995, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin P. nr. 438/94, me të cilin miratoi kërkesëpadinë e PPK-së, me ç'rast e shpalli të pavlefshëm kontratën e shitblerjes Ov. nr. 2841/64, të 18 dhjetorit 1964.
17. Gjykata, në bazë të shkresave të lëndës, vëren se pas shpalljes së pavlefshmërisë së kontratës, parashtruesit të kërkesës i është kthyer pronësia mbi 1.45.49 hektarë tokë, ndërsa sipërfaqja prej 1.15.89 hektarë tokë, nuk ka mundur të kthehet për shkak të faktit se kjo pjesë e tokës, tanimë i është dhënë disa palëve të treta si kompensim, duke e transferuar atë në pronësinë e tyre.
18. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës dhe e paditura "MDD Ratar", dështuan të arrijnë marrëveshje në lidhje me shumën e kompensimit financiar që duhet t'i paguhet parashtruesit të kërkesës si kompensim për pjesën e tokës prej 1.15.89 hektarëve që nuk mund t'i kthehej atij.
19. Më 24 dhjetor 2008, parashtruesi i kërkesës ngriti kërkesëpadi SCC-08-0305 në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) kundër "KBI-së" dhe "MDD Ratar", përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar kthimin e 1.15.89 hektarëve të tokës.
20. Më 12 prill 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme në të cilën ai propozoi që atij t'i jepej si kompensim për pjesën e tokës që nuk i është kthyer, t'i ndahet një parcelë tjetër e tokës [nr. 1394/1] në sipërfaqe të njëjtë prej 1.15.89 ha, e cila është regjistruar në listën poseduese nr. 222, zona kadastrale në Çagllavicë.

21. Më 4 shtator 2012, në Dhomën e Posaçme u mbajt seanca dëgjimore, ku palët në procedurë paraqitën qëndrimet e tyre.
22. Më 25 shtator 2012, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin SCC-08-0305, me të cilin kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kthim të 1.15.89 hektarëve të tokës u refuzua si e pabazuar, në arsyetimin e aktgjykimit thuhet:

*“Nuk ka bazë ligjore që paditësit t’i jepet kompensim për tokën që nuk ka arritur ta kthejë pasi kontrata e shitblerjes është shpallur e pavlefshme. Neni 104 i Ligjit për marrëdhënie detyimore parasheh që, në rast të pavlefshmërisë së kontratës, secila palë kontraktuese është e detyruar t’ia kthejë tjetrës të gjitha ato që ka marrë në bazë të një kontrate të tillë. Nëse njëra prej palëve nuk është në gjendje ta kthejë atë që ka fituar me kontratë, atëherë ligji parasheh kompensim adekuat. Kthimi i tokës që i është shitur palës tjetër nuk është e mundur për shkak se e paditura e ka shitur atë. Në këto rrethana, paditësi do të kishte të drejtën e kompensimit për atë pjesë të tokës që nuk iu kthye atij, por kjo do të ishte vetëm kompensim monetar, e jo kompensim në formën e një toke të tillë. Nëse paditësit i është dhënë një tokë e tillë në pronësi të të paditurit, kjo do të nënkuptonte privatizimin e pronës shoqërore në një mënyrë që nuk është paraparë me ligj dhe është në kundërshtim me ligjin”.*

23. Më 19 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, të 25 shtatorit 2012, duke theksuar se Kolegji i Specializuar ka shkelur dispozitat e LPK-së, sepse aktgjykimi përmban mangësi të konsiderueshme, gjithashtu në procesverbalin nga seanca dëgjimore e 4 shtatorit 2012, nuk është përfshirë pozicioni i tij alternativ me gojë në formën e një kërkesë me të cilin ai e pranoi edhe kompensimin monetar si opsion alternativ, por Kolegji i Specializuar asnjëherë nuk e ka shqyrtuar këtë kërkesë sepse dikush e ka manipuluar procesverbalin. Gjithashtu, parashtruesi deklaroi se procesverbali nuk i ishte dorëzuar atij në pajtim me nenin 138, paragrafi 3, dhe nenin 139, paragrafi 1 i LPK-së.
24. Më 26 prill 2018, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin AC-1-12-0112-A0001, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.
25. Në arsyetimin e aktvendimit thuhet:

*“Kolegji i Apelit konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara. Siç thuhet, është e qartë se paditësi kërkoj kompensim in rem dhe nuk kërkoj asnjë kompensim monetar. Kjo konfirmohet edhe nga procesverbali, ku theksohet qartë dhe drejtpërdrejtë çështja e gjyqtarit për paditës. Pretendimi ankimor se ai kishte kërkuar kompensim alternativ nuk bazohet në prova materiale.*

*Sa i përket pretendimit të dytë se ka qenë obligim i gjykatës, në pajtim me nenin 139, paragrafi 1 i LPK-së, dhe në pajtim me nenin 138, paragrafi 3, t’ua dorëzojë procesverbalin palëve në procedurë brenda 3 ditëve për të*



*parashtruar kundërshtimet e tyre, Kolegji i Apelit konsideron se kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm nëse procesverbali i seancës dëgjimore nuk është mbajtur”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31, paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 24, paragrafi 1 dhe 2 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Kosovës, si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.
27. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon, se nuk është kontestues fakti se ai parashtroi kërkesëpadi në vitin 2008, për vërtetimin e të drejtave pronësore, të cilën e plotësoi më 12 prill 2011, në të cilën kërkoi që në emër të kompensimit për ngastrën e tij ta kthejë ekskluzivisht parcelën nr. 1394/1.
28. Megjithatë, edhe sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës nuk është kontestues fakti se, gjatë seancës dëgjimore të 4 shtatorit 2012, në Dhomën e Posaçme me gojë ka paraqitur qëndrimin e tij në formën e kërkesës në të cilën ai deklaroi se si formë alternative të kompensimit për tokë gjithashtu do të pranojë kompensimin monetar.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon më tej se gjatë seancës gjyqësore ka ardhur deri te manipulimi i procesverbalit dhe se kërkesa e tij alternative me gojë nuk është regjistruar në versionin përfundimtar të procesverbalit, e cila çoi në atë që Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të nxjerrin vendime vetëm për sa i përket kërkesëpadisë për vërtetimin e të drejtave pronësore nga viti 2008-2011, dhe jo në lidhje me kompensimin monetar, të cilin ai e kërkoi me gojë gjatë seancës shqyrtuese të vitit 2012. Ai konsideron se me këtë është diskriminuar drejtpërdrejt sepse gjykatat në raste të ngjashme sa i përket çështjes së kompensimit kanë marrë vendime të ndryshme nga ana e tij.
30. Gjithashtu, parashtruesi konsideron se gjatë procedurave para gjykatave të rregullta është shkelur Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, respektivisht, se procesverbali i seancës shqyrtuese të 4 shtatorit 2012 nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 138, pika 3 dhe nenin 139, paragrafi 1 të LPK-së, dhe me këtë ka ardhur deri te shkelja e Ligjit të Procedurës Kontestimore.
31. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që ta shpallë kërkesën e tij të pranueshme, të konstatojë se gjykatat kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese dhe gjithashtu ta anulojë Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe Aktvendimin e Kolegjit të Apelit si të pavlefshëm, dhe ta detyrojë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të nxjerrë aktgjykim të drejtë dhe meritore në lidhje me kërkesën e tij.

## Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Gjykata në vijim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç është përcaktuar në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

### Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

### Neni 49 [Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.*

35. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin AC-1-12-0112-A0001 të Kolegjit të Apelit, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e parashtruara në nenin 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e paraparë në nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) i Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
37. Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të disa neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, megjithatë, Gjykata



gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës të gjitha ato shkelje i sjellë në lidhje me faktin se gjatë seancës shqyrtuese pranë Dhomës së Posaçme parashtroi një qëndrim alternativ në formën e një kërkesë ku ai propozoi t'i paguhej një kompensim monetar në emër të kompensimit për tokë, por që gjatë seancës kishte ardhur deri te manipulimi me procesverbal dhe se gjykatat nuk kishin vendosur kurrë për atë kërkesë.

38. Gjykata konstaton se në thelb të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë kryesisht me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.

***Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

39. Gjykata, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, vëren se ai konsideron se nuk ka pasur gjykim të drejtë për shkak të faktit se dikush ka manipuluar me procesverbal dhe se rrjedhimisht, gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, që përfundimisht rezultoi që ato të mos vendosin për kërkesën e tij alternative me gojë, por kishin vendosur vetëm sa i përket padive të vitit 2008/2011. Gjithashtu në mbështetje të pretendimit të tij për shkelje të pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë, parashtruesi i kërkesës shton edhe faktin se procesverbali nga seanca gjyqësore nuk i është dorëzuar në pajtim me nenin 138, pika 3 dhe nenin 139 paragrafi 1 i LPK-së, me çka është shkelur edhe LPK-ja.
40. Gjykata, duke pasur parasysh shkresat e lëndës, para së gjithash vëren se procedura në fjalë ka të bëjë me vërtetimin e të drejtave pronësore në lidhje me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, të cilën ai e filloi në vitin 2008, dhe e specifikoi me parashtrësën me shkrim në vitin 2011. Pra, në rastin konkret, bëhet fjalë për rastin me natyrë civile-juridike, nga e cila rrjedh se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së janë të zbatueshëm.
41. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata thekson se, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës Kushtetuese, detyra e këtyre gjykatave nuk është të rishqyrtojnë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (Shih GJEDNJ, *Pronina kundër Rusisë*, Vendim për pranueshmëri, i 30 qershorit 2005, numri i kërkesës 65167/01).
42. Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 10 majit 2005, kërkesa nr. 19354/02). Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të shqyrtojë nëse, eventualisht, ka ardhur deri te shkelja apo shpërfillja e të drejtave kushtetuese (E drejta për gjykim të drejtë, e drejta

për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar.

43. Prandaj, Gjykata Kushtetuese do të lëshohet posaçërisht në shqyrtimin e mënyrës në të cilën gjykatat kompetente kanë vërtetuar faktet dhe kanë zbatuar rregullat pozitive ligjore në faktet e vërtetuara, kur është e qartë se në procedurën e caktuar ka ardhur deri te veprimi arbitrar i gjykatës së rregullt, si gjatë procedurës së përcaktimit të fakteve, po ashtu edhe gjatë zbatimit të rregullave pozitive-juridike përkatëse.
44. Megjithatë, në rastin në fjalë, Gjykata vëren se më 24 dhjetor 2008, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesëpadi për vërtetimin e të drejtave pronësore dhe se më 12 prill 2011 ai kishte specifikuar kërkesëpadinë primare me një të re në të cilën ai kërkoi ekskluzivisht vërtetimin e një të drejte pronësore mbi një ngastër të caktuar si një formë kompensimi për parcelën e tij.
45. Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Specializuar, duke pasur parasysh kërkesëpadinë primare të vitit 2008, si dhe kërkesëpadinë e specifikuar të parashtruesit të kërkesës të vitit 2011, nxori aktgjykimin në të cilin konstatoi se kërkesëpadiat nuk mund të realizohej në formën e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës.
46. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar nxori aktgjykimin ekskluzivisht në lidhje me mundësinë e kompensimit në formën në të cilën parashtruesi e ka kërkuar me kërkesëpaditë e vitit 2008 dhe 2011, dhe ky është kompensimi *in rem*, dhe jo sipas kërkesës me gojë në lidhje me kompensimin monetar të cilën parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur me gojë si një opsion alternativ.
47. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në ankesën pranë Kolegjit të Apelit theksoi të njëjtat pretendime si para kësaj Gjykate, duke theksuar se *“ka pasur manipulim të procesverbalit të seancës shqyrtuese, dhe se Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar bazohet në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike”*.
48. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit mori parasysh pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, që rezultoi në faktin që ai ka shqyrtuar dhe analizuar procesverbalet e kontestuarra të seancës shqyrtuese të mbajtur, me ç’rast gjeti se është fakt i pakontestueshëm se më 4 shtator 2012 është mbajtur seanca shqyrtuese në Dhomën e Posaçme, dhe se Kryetari i Kolegjit të Specializuar lidhur me kërkesën e parashtruesit për kompensim, parashtroi pyetjen *“nëse parashtruesi kërkon vetëm tokë për tokë, në të cilën përfaqësuesi ligjor i paditësit (parashtruesit të kërkesës) u përgjigj po, vetëm tokë për tokë”*.
49. Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit nxori vendimin në të cilin konkludoi se pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës sipas këtij pretendimi ankimor, janë të pabazuara, sepse bazuar në procesverbal rrjedh se parashtruesi kërkoi ekskluzivisht që Kolegji i Specializuar të vendosë për çështjen e kompensimit tokë për tokë, dhe jo sa i përket mundësisë së kompensimit monetar si një nga opsionet alternative.



50. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të theksojë në veçanti se sipas mendimit të saj, Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kanë arritur drejt në përfundimet e tyre, për shkak se gjykatat e rregullta nuk kanë juridiksion të dalin përtej fushëveprimit të kërkesëpadive dhe të vendosin për këto çështje apo të gjykojnë.
51. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos vërejë se Kolegji i Apelit gjithashtu ka trajtuar edhe pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës, të cilat ai i inicioi edhe para kësaj Gjykate, dhe ky është pretendimi se procesverbali i seancës shqyrtuese nuk i është dorëzuar atij në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 138, paragrafi 3 dhe nenit 139, paragrafi 1 i LPK-së. Në këtë drejtim, Kolegji i Apelit ka gjetur se *“në pajtim me nenin 138, paragrafi 2 dhe në pajtim me nenin 139, paragrafi 1 të LPK-së, procesverbali do t'u dërgohet palëve brenda 3 (tri) ditëve për të paraqitur kundërshtimet e tyre, Kolegji i Apelit konsideron se kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm nëse në seancë procesverbali nuk është mbajtur”*.
52. Bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata konkludon se nuk ka gjetur asgjë që në rastin konkret do të tregonte se dispozitat ligjore materiale në rastin konkret ishin zbatuar në mënyrë arbitrare ose të padrejtë në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjykata gjithashtu konsideron se parashtruesi nuk ofron fakte që mund të justifikojnë pretendimin se ka shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat ai thirret, dhe për këtë arsye nuk ka elemente që *prima facie* tregojnë se është e mundur shkelja e të drejtave kushtetuese sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, dhe duhet të kërkohej një shqyrtim meritor.

***Pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së***

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, si argument kryesor për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, thekson faktin se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kanë nxjerrë aktgjykime dhe vendime të gabuara dhe si rrjedhojë, ai nuk ka fituar kompensim për tokën e tij në formën e kompensimit monetar, që do të ishte në përpjesëtim me vlerën e ngastrës së tij të tokës.
54. Gjatë shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ka “pronë” në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, sipas praktikës së qëndrueshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, “prona” në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së mund të jetë ose “pronë ekzistuese” ose “asete”, përfshirë edhe kërkesat në lidhje me të cilat personi së paku ka “pritje legjitime” për realizimin e tyre (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Jantner kundër Sllovakisë*, të 4 marsit 2003, numër 39050/97).

56. Me këtë rast, Gjykata thekson se “pritja legjitime” duhet të jetë shumë më konkrete se vetë shpresa, sado e arsyeshme mund të jetë, dhe duhet të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor siç është vendimi gjyqësor (Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Kopecký kundër Sllovakisë*, numri i kërkesës 44912/98 i 28 shtatorit 2004, par. 48-49;).
57. Duke i sjellë parimet e lartpërmendura në lidhje me rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit kishin trajtuar ekskluzivisht kërkesat e ngritura nga parashtruesi me padi për përcaktimin e së drejtës pronësore.
58. Gjykata konsideron se nga sa më sipër rrjedh që parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të kishte “pritje legjitime” që Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit do të nxjerrin vendime në lidhje me kompensimin monetar, meqë një kërkesëpadi e tillë në bazë të gjetjeve të tyre, ai nuk e kishte dorëzuar asnjëherë para tyre për vendosje.
59. Rrjedhimisht, meqenëse “pritja legjitime” duhet të bazohet në dispozitën ligjore ose një akt të caktuar ligjor, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ai ka një “kërkesë të realizueshme”, e cila do të përbënte “pronën” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
60. Gjykata konkludon se nuk ka shkelje të së drejtës në pronë sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

***Pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së***

61. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se është diskriminuar me vendimet e kontestuara të Kolegjit të Specializuar dhe të Kolegjit të Apelit, pasi që “në situata të ngjashme lidhur me çështjen e kompensimit kanë marrë vendime të ndryshme nga ai i tij”.
62. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ankohet për shkelje të së drejtës për mosdiskriminim sipas nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së, në lidhje me të drejtën e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
63. Gjykata rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për mosdiskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ-së është një e drejtë shtesë. Kjo do të thotë se ky nen nuk siguron një të drejtë të pavarur dhe autonome për mosdiskriminim, por në diskriminim sipas këtij neni mund të thirret vetëm në lidhje me “gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNJ”.
64. Ndonëse konstatimi i shkeljes së ndonjëres nga të drejtat e garantuara nuk është parakusht për zbatimin e nenit 14 të KEDNJ-së, megjithatë, ky nen nuk do të mund të zbatohet nëse faktet e rastit në fjalë nuk bien “në kuadër” të të drejtave të garantuara (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë*, i 18 korrikut 1994, Seria A numër 291-B, paragrafi 22).



65. Në rastin konkret, Gjykata tashmë ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur “pronë” në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për ç’ arsye pretendimet e tij nuk bien brenda fushëveprimit të këtij neni, ashtu që neni 14 i KEDNJ-së nuk mund të zbatohet.
66. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës në pretendimet e tij vetëm thekson se ai është diskriminuar “*sepse gjykatat në situata të ngjashme lidhur me çështjen e kompensimit kanë marrë vendime të ndryshme nga ai i tij*”, me ç’rast ai nuk ka paraqitur asnjë provë që do të mundte, *prima facie*, t’i bëjë të mundura pretendimet për shkelje të kësaj të drejte.
67. Në bazë të kësaj, Gjykata konsideron se pretendimet për shkelje të së drejtës për mosdiskriminim sipas nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën pronësore sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, janë qartazi (*prima facie*) të pabazuara, sepse faktet e paraqitura nuk mund të justifikojnë në asnjë mënyrë pretendimin se ka shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
68. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t’i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syl*a, të 5 dhjetorit 2013).
69. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2019, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Safet Hoxha



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi